



PROSOUND

LOADING INNOVATION



Historia

“E vetmja mënyrë për të bërë një punë të shkëlqyer është ta duash atë që bën!”

PROSOUND e filloi aktivitetin e saj në vitin 2006, nxitur nga dashuria dhe pasioni për botën audio-vizuale. Që nga ai moment kompania është rritur gradualisht duke siguruar jo vetëm produktet dhe përvojen më të mirë në treg, por duke sjellë gjithashtu ide dhe risi inovative. Në këtë mënyrë PROSOUND vendosi standarte të reja në tregun audio-vizual në Shqipëri.

Misioni ynë kryesor është të përmbushim kërkesat e klientëve dhe të ofrojmë një shërbim të përkryer, për këtë ne do të vazhdojmë të përmirësojmë më tej aftësitë tona operacionale, të zhvillojmë njerëzit e ekipit tonë si dhe të investojmë në teknologji të reja.

Vizioni ynë është të vazhdojmë të udhëheqim në tregun profesional audiovizual duke siguruar produkte dhe shërbime cilësore për klientët tanë si dhe për të qënë një partner i besueshëm për kontraktuesit e tjerë

Inovacioni ka qënë dhe është thelbësor për kompaninë tonë. Ai është katalizatori për rritje, ndaj çdo ide e re, proces apo zgjidhje më e mirë, aplikohet nga ne për të plotësuar kërkesat e reja apo dhe nevojat ekszistuese të tregut.

Përse PROSOUND



Misioni

Seriozitet dhe profesionalizëm për të përmbushur pritshmëritë e klientit.



Përfitoni

Shërbimet më të mira në treg, me cmimet më të arsyeshme.



Koherent

Përditësojmë vazhdimisht pajisjet dhe shërbimet tona duke qëndruar koherent në treg.



Takim Paraprak

Të fokusuar ndaj klientit, duke ofruar gadishmëri për të diskutuar mbi kërkesat tuaja.



Eksperiencë

Teknikët tanë me eksperiencë do të kujdesen për mbarëvajtjen e eventit tuaj.



Suport

Një event menaxher do të asistojë përgjatë gjithë eventit për të garantuar suksesin e tij.



Vite në tregun audiovizual

Mbi 1000 evente në vit, nga të cilat 50 evente me rëndësi të vecantë .

Çertifikata ISO dhe çmime të tjera

Prosound prej vitesh ofron standarte ndërkombëtare për garantimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Kompania zotëron shtatë certifikata ISO për të pasur një stimul të vazhdueshëm për përmirësimin dhe përmbushjen e kënaqësive të klientit. Vitet e fundit, Superbrands Albania ka vlerësuar Prosound, si “zgjedhja e parë e shqipëtarëve” në fushën audiovizuale.



Shërbimet Tona

Foni

Ne jemi të specializuar në ofrimin e shërbimeve profesionale të fonisë. Përvoja jonë e gjatë dhe përdorimi i teknologjive më të fundit nga brandet botërore përmirëson cilësinë dhe performancën e projekteve tuaja.

Top Brands :

- L-Acoustics
- dBTechnologies
- JBL Pro

Shërbimet Tona

Ndriçim

Ndriçimi është elementi kryesor për një event të suksesshëm. Qellimi ynë është të sigurojmë një përvojë mahnitëse dhe tërheqëse për të pranishmit.

Ne ofrojmë një gamë të gjerë të llojeve të ndriçimit si: mediatik, me efekte, të automatizuar, arkitekturor etj.

Top Brands:

- Chauvet Lighting
- BeamZ
- Briteq
- Martin
- Portman

Shërbimet Tona

Ekran Led

Prezantimi i projekteve të ndryshme në ekranet LED ndihmon për të përmirësuar komunikimin vizual në konferenca, trajnime dhe evente të tjera. Përdorimi i ekraneve me rezolucion të lartë ka për qëllim të sigurojë një cilësi të imazhit, kontrastit dhe ndriçimit. Ne ofrojmë sisteme interaktive si Touchscreen për të përmirësuar angazhimin dhe interaktivitetin gjatë prezantimeve.

Gjithashtu risi në tregun tonë është ekrani LED harkor me rezolucion 2.6mm.

Shërbimet Tona

Video

Prosound është lider në shërbimet video dhe 3D mapping, duke ofruar zgjidhje inovative dhe të personalizuarra për çdo klient. Me një ekip të kualifikuar dhe me përvojë të gjatë, ne përdorim teknologjinë më të avancuar për të siguruar prezantime mbresëlënëse. Eksperienca jonë në projekte unike dhe përkushtimi ndaj cilësisë na bën partnerin ideal për çdo nevojë vizuale, duke garantuar profesionalizëm dhe integritet në çdo bashkëpunim.

Shërbimet Tona


Skena

Ne krijojmë skenografi të personalizuar për eventin tuaj. Pavarësisht nga madhësia ose lloji i eventit ofrojmë një setup të përshtatshëm, i cili përmbush standardet më të larta të performancës dhe sigurisë. Përvoja jonë në industrinë e skenave të koncerteve është garanci për një dizajn të përsosur dhe inovativ.











Shërbimet Tona

Efekte Speciale

Efektet speciale i japin një dimension shtesë eventeve tuaja. Këto efekte si tym i rëndë, CO2, flakë, confeti krijojnë një atmosferë euforike dhe shpërthim energjie midis artistëve dhe publikut. Përdorimi i efekteve speciale të sinkronizuara me ritmin dhe melodinë e muzikës krijojnë një përvojë audiovizuale të paharrueshme.



Kategoritë e eventeve



Koncerte

Përjeto emocionin

Me një eksperiencë të gjatë në treg, që prej vitit 2006, ne bashkëpunojmë me artistët më në zë dhe organizatorët më të njohur në fushën e koncerteve.

Shiko më shumë [➤](#)



Kulturore

Tradita e artit në skenë

Ne jemi aty për të mbështetur dhe krijuar atmosferën e duhur për kulturën shqiptare me evente të ndryshme nga skena e një teatri, deri në salla të mëdha apo sheshe

Shiko më shumë



Konferenca

Vizioni juaj bëhet realitet

Sfida jonë është të ofrojmë të njëjtin standart shërbimi në të gjitha llojet e sallave. Kemi arritur të përmbushim me profesionalizëm kërkesat organizative, duke ofruar pajisjet e teknologjisë së fundit.

Shiko më shumë





Promocione

Produkti juaj në qëndër të vëmendjes

Ju ofrojmë eksperiencën shumëvjecare dhe teknologjinë më të fundit për promovimin e produktit tuaj.

Shiko më shumë



Live Band & DJ

Eksperiencë mbresëlënëse

Nëse artistët performojnë me pajisje të një cilesie të lartë, impakti që përcillet tek publiku është mbresëlënës. Për ta bërë këtë të mundur, Prosound ofron markat më të njohura ndërkombëtare.

Shiko më shumë [➔](#)



Dasma

Dita juaj më e bukur

Sekreti qëndron tek magjia e ndriçimit! Ne ofrojmë një gamë të gjerë shërbimesh profesionale për ditën tuaj më të bukur.

Shiko më shumë [➔](#)






Festa

Ne jemi festa juaj

Shpërblimi ynë më i madh është emocioni juaj. Festojmë së bashku ditët tuaja më të lumtura me organizime nga më të veçantat.

Shiko më shumë



Sfilata

Arti i së bukurës

Krijimtaria e një stilisti apo një kompeticion bukurie nuk ka kuptim pa ndriçimin në artin skenik. Ne mbështesim idetë tuaja për të pasur rezultate mbresëlënëse.

Shiko më shumë 






Evente publike

Ne jemi aty me ju

Eventet më të rëndësishme nga institucionet qeveritare ose shoqata jo fitimprurëse, kanë gjithmonë përkujdesjen tonë për të krijuar impakt në publik.

Shiko më shumë



Evente sportive

Le të fitojë më i miri

Nuk ka rëndësi nëse është lojë, garë apo show, e rëndësishme është të përfshihen spektatorët. Ne jemi aty, le të fitojë më i miri

Shiko më shumë



Rezervoni Eventin Online

Rezervoni Evente

Eventi Tirana Zgjidh datën Orari i fillimit >>

15000+
Evente

985+
Klientë të lumtur

19
Vite Eksperiencë